

Në kërkim të konsensusit: Një propozim

—

Dhjetor, 2017





GRUPI PËR STUDIME
JURIDIKE DHE
POLITIKE

Grupi për Studime Juridike dhe Politike

Është një organizatë e pavaraur, jopartiake dhe jo-fitimprurëse e politikave publike me qendë në Prishtinë, Kosovë.

Misioni ynë është që të zhvillojmë hulumtime të besueshme në fushën e politikës, ligjit dhe ekonomisë dhe të shtyjme përpara zgjidhjet e politikave që adresojnë dështimet dhe/ ose trajtojnë problemet në fushat e politikave të lartpërmendura.

Analizë Politikash 05/2017

Në kërkim të konsensusit: Një propozim

Autor: Agron Bajrami*

Dhjetor 2017

© Grupi për Studime Juridike dhe Politike, Dhjetor, 2017.

Opinionet e shprehura në këtë dokument jo domosdoshmërisht pasqyrojnë qëndrimet e stafit të Grupit për Studime Juridike dhe Politike, donatorëve e këshillit, stafit të tyre, apo anëtarëve të bordit. Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Asnjë pjesë e këtij publikimi nuk mund të riprodhohet apo përdoret në çfarëdo forme pa leje paraprake. Për kërkesa të kësaj natyre kontaktoni zyrën administrative të Grupit për Studime Juridike dhe Politike.

Grupi për Studime Juridike dhe Politike
Rr. "Rexhep Luci", 16/1
Prishtinë 10 000, Kosovë
Ueb : www.legalpoliticalstudies.org
E-mail: office@legalpoliticalstudies.org
Tel/fax.: +381 38 234 456

*Kryeredaktor në Koha Ditore



Kjo Analizë Politikash publikohet në kuadër të projektit “Normalizimi i Dialogut Kosovë-Serbi”, mbështetur nga Fondacioni Kosovar për Shoqëri të Hapur (KFOS)

NË KËRKIM TË KONSENSUSIT: NJË PROPOZIM

HYRJE

Ka gati një vit që Dialogu i Brukselit po stagnon.¹ Marrëveshje të reja nuk ka, ato që janë arritur ose zbatohen me shumë vështirësi, ose nuk zbatohen fare, ndërsa kohë pas kohe janë shënuar edhe tensionime dramatike. Dimri i kaluar kaloi në shenjë konfrontimesh të ashpra mes Kosovës dhe Serbisë; vetëm gjatë muajve dhjetor 2016 dhe janar 2017 kishte disa përplasje publike, dhe atë jo vetëm në fushën e deklaramëve nxitëse që rëndom konsiderohen të jenë “politikë ditore për nevoja të brendshme”,² por edhe me veprime që në momente rrezikonin përshkallëzimin e situatës në një konfliktit të hapur në terren³.

Mungesa e progresit dhe konfrontimet e shpeshtuara mes Kosovës dhe Serbisë kanë krijuar ambient të favorshëm që kërkesat për një rimendim të gjithë procesit të merren seriozisht edhe nga bashkësia ndërkombëtare, e cila tanimë duket e hapur (dhe e vendosur) për të ndryshuar Dialogun e Brukselit, posaçërisht meqë liderët e të dy palëve janë shprehur në favor të një ndryshimi përmbajtjesor.⁴ Rrjedhimisht ka disa muaj që diskutimi se çfarë duhet të jetë formati i ri i dialogut, dhe nëse ai duhet të ketë dhe një përmbajtje të ndryshuar, po ndodh edhe publikisht.

Në Kosovë propozimet përfshijnë kalimin e dialogut nën udhëheqjen e presidentit të Kosovës, krijimin e një Ekipi të Unitetit ngjashëm me atë që ka marrë pjesë në negociatave për statusin e Kosovës në Rambouillet më 1999 dhe Vjenë më 2007, kalimi i përgjegjësisë për dialogun e Brukselit të Kuvendi i Kosovës, apo edhe mbetja e këtij procesi si mandat i Qeverisë së Kosovës, me mbikëqyrje parlamentare.

Megjithatë, përkundër debateve dhe diskutimeve të shtuara publike, deri më tani që të gjitha propozimet, përveç përkrahësve, kanë edhe kundërshtuesit e tyre, dhe përgjithësisht nuk duket se ende ekziston një formulë e kompromisit që do të përkrahej nga shumica e partive politike parlamentare dhe shoqëria kosovare.

Ndërsa problem shtesë tani është se koha për vendime po skadon me shpejtësi, meqë vetë Bashkimi Evropian po e humb durimin me palët, dhe ngecja në dialogu nënkupton edhe ngecje në procesin e integritimeve evropiane të të dy vendeve, edhe Kosovës edhe Serbisë, pasi që këto dy procese – dialogu për normalizim dhe integrimi evropian – tashmë janë lidhur njëri me tjetrin.⁵

Kush duhet ta udhëheqë dialogun?

Presidenti

Derisa në Beograd presidenti i Serbisë, Aleksandar Vuçiq, ka hapur një të ashtuquajturin *dialog i brendshëm* për Kosovën, që zyrtarisht synon të definojë një qëndrim të ri të Serbisë ndaj çështjes së Kosovës,⁶ në Prishtinë, me veprimet e fundit presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, tashmë duket

¹ Dialogu mes Kosovës dhe Serbisë, i lehtësuar nga BE-ja, zyrtarisht është emërtuar “Dialogu për normalizimin e marrëdhënieve mes Beogradit dhe Prishtinës”

² Pothuaj secili diplomat perëndimor në biseda private i cilëson kështu deklaratat e tilla

³ Rasti i trenit të dekoruar me motive nacionaliste e fetare serbe.

⁴ Bisedë me një diplomat evropian

⁵ Normalizimi i marrëdhënieve me Kosovën është pjesë e Kapitullit 35 të procesit të negociatave për anëtarësim mes BE-së dhe Serbisë, ndërsa progresi në dialog me Serbinë është pjesë e Marrëveshjes për Asociim dhe Stabilizim të Kosovës me BE-në

⁶ “Dialogu i brendshëm” rreth Kosovës, i hapur nga presidenti Vuçiq, tashmë ka prodhuar një valë polemikash e diskutimesh, mes të cilave ka një përsëritje të ideve të vjetra të ndarjes së Kosovës mes shqiptarëve dhe serbëve, të promovuara me ngulm nga ministri i Jashtëm, Ivica Dačić

qartë se e ka marrë timonin e dialogut në duart e veta⁷. Përveç pjesëmarrjes së vetë presidentit Thaçi në takimet e nivelit të lartë në Bruksel, dëshmi për rolin më aktiv të Presidencës në këtë proces është edhe rasti i fundit, në shtator, kur një këshilltar i presidentit Thaçi ishte paralajmëruar si pjesëmarrës në një konferencë ndërkombëtare në Beograd si “koordinator për dialog”, pa një emërim zyrtar të këshilltarit presidencial në këtë post.⁸

Megjithatë, së paku tek bashkësia ndërkombëtare, ka një perceptimit se nga ana e Kosovës nuk ka kush tjetër që e udhëheqë dialogun. Këtij këndvështrimi i ka ndihmuar edhe kriza politike pas zgjedhjeve të përgjithshme, që u përmyll me formimin e një qeverie me përkrahje minimale parlamentare.⁹ Andaj, për pjesë të bashkësisë ndërkombëtare që janë të përfshira në dialog, posaçërisht për lehtësuesit/ndërmjetësit e BE-së me përfaqësuesen Federica Mogherini në krye, ngritja e dialogut në nivel presidencial duket se shihet si zhvillim pozitiv.¹⁰

Kjo nuk përbën risi. Përgjithësisht, në shërbimin e jashtëm të BE-së në vazhdimësi është konsideruar se dialogu mund të prodhojë më shumë nëse në të janë përfshirë më pak vendim-marrës lokalë; qysh nga koha kur dialogu është nisur nën kryesimin e përfaqësueses së lartë të BE-së, Catherine Ashton, synimi ishte që “puna të kryhej me dy liderët kryesorë nga dy kryeqytetet, fillimisht ish-in Thaçi e (Boris) Tadiqi, mandej Thaçi e (Ivica) Daçiçi, tani janë Thaçi e (Aleksandar) Vuçiçi”.¹¹ Kjo formulë – që dialogu të mbështetet në dy individë kryesorë - mbase edhe mund të funksionojë në Serbi, ku presidenti Vuçiçi ka pushtet të pakontestueshëm, së paku për momentin.¹² Por jo edhe në Kosovë.

Bazuar në deklaratimet e ndryshme të partive politike të Kosovës dhe segmenteve nga shoqëria civile, si dhe raportit aktual të forcave në Kuvendin e Kosovës, duket qartë se ka një mospajtim të thellë mes partive kosovare rreth asaj se si duhet të duket dialogu në të ardhmen.

Marrjen e kryesimit të dialogut nga presidenti Thaçi tashmë e kanë kundërshtuar dy partitë e mëdha opozitare, Lëvizja Vetëvendosje dhe Lidhja Demokratike e Kosovës¹³, derisa partitë e koalicionit qeverisës¹⁴ (PDK, AAK, Nisma dhe AKR) nuk duket se kanë formuluar një pozicion të përbashkët.¹⁵

Po ashtu, duket qartë se në tre vjetët e fundit fuqia politike e Hashim Thaçit është reduktuar shumë; në mars të vitit 2016 ai mezi ka siguruar votat për t’u zgjedhur president i vendit, ndërsa partia e tij politike PDK, e cila prej vitit 2007 ka qenë forca më e madhe politike në vend, tashmë ka rënë në vendin e tretë për nga numri i deputetëve në Kuvendin e Kosovës.¹⁶

⁷ Presidenti Thaçi ka paralajmëruar kalimin e dialogut në nivel presidencial që vitin e kaluar, pak kohë pasi ai vetë u zgjodh president. Së fundi, pas pjesëmarrjes në dy takime të Dialogut të Brukselit, në nivel presidentësh, ai ka paralajmëruar edhe krijimin e një Ekipi të Unitetit, dhe marrjen e një serie tjetër masash që qartë tregojnë se timoni i procesit prej Qeverisë ka kaluar në Presidencë (për më shumë rreth pozicionit të presidentit, shih OpEd-in e tij, botuar në “Koha Ditore”, faqe 11, 30 gusht 2017).

⁸ Këshilltari i presidentit, Blerim Shala, ishte paraparë të marrë pjesë në panelin “Dialogue between Prishtina and Belgrade: From normalization to normality”, në konferencën e Forumit të Beogradit për Siguri, por në momentin e fundit Shala anuloi pjesëmarrjen.

⁹ Bisedë me një diplomat evropian

¹⁰ Bisedë me një diplomat evropian

¹¹ Bisedë me një diplomat evropian

¹² Vuçiçi këtë vit ka fituar në zgjedhjet presidenciale me më shumë se 50 për qind të votave, partia e tij ka më shumë se gjysmën e deputetëve në Kuvendin e Serbisë, ndërsa burime serbe flasin se ai kontrollon pothuajse të gjitha institucionet shtetërore dhe publike, si dhe shumicën e mediave në Serbi.

¹³ Edhe kryetari i VV-së, Visar Imeri, edhe ai i LDK-se, Isa Mustafa, kanë refuzuar propozimet e Thaçit për krijim të një Ekipi të Unitetit për dialog me Serbinë nën kryesimin e presidentit

¹⁴ Fjala është për partitë kryesore shqiptare: Partia Demokratike e Kosovës, Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, Nisma për Kosovën dhe Aleanca për Kosovën e Re

¹⁵ Disa deklaratime janë bërë nga krerët e këtyre partive, por jo si një pozicion i përbashkët qeveritar, ndërsa nuk ka as një komunikatë zyrtare të Qeverisë Haradinaj në lidhje me propozimet e presidentit Thaçi

¹⁶ VV dhe LDK kanë më shumë deputetë sesa PDK, e cila në zgjedhjet e fundit parlamentare garoi në listë të përbashkët me AAK-në dhe Nismën.

Përveç kësaj, mandati i presidentit për të udhëhequr dialogun, përveçse është i kundërshtuar nga një pjesë domethënëse e spektrit politik që përfaqëson rreth 50 për qind të votuesve shqiptarë, ai është i kontestueshëm edhe për faktin se deri në këtë moment, vetëm Qeveria e Kosovës është e mandatuara nga Kuvendi i Kosovës për t'u përfshirë në dialog me Serbinë për normalizim marrëdhëniesh.¹⁷ Rrjedhimisht, një mandat i ri për përfshirje në Dialogun e Brukselit do të duhej të marrë miratimin e Kuvendit të Kosovës. Kjo, marrë parasysh disponimin e partive parlamentare ndaj pozicionit të presidentit aktual, e bën pothuajse të pamundur udhëheqjen e dialogut prej tij.

Megjithatë, është e qartë, po ashtu, se ky kundërshtim ka më pak të bëjë me parimin e udhëheqjes së dialogut nga presidenti i zgjedhur i Kosovës, e më shumë me personalitetin e presidentit aktual, Hashim Thaçi, i cili në masë të madhe nuk shihet si president që përfaqëson unitetin e popullit, po më shumë si një që përfaqëson interesat e një pjese të skenës politike të Kosovës, para së gjithash PDK-së, partisë të cilën e themeloi dhe e udhëhoqi për gati 17 vjet.¹⁸

Qeveria

Në anën tjetër, Qeveria e re e Kosovës fillimisht ka treguar pak interesim për procesin e dialogut. Kryeministri i ri, Ramush Haradinaj, nuk ka emëruar një ministër për dialog, siç ka qenë rasti në dy Qeveritë paraprake të Kosovës.¹⁹ Haradinaj, para se të zgjidhej kryeministër, ka insistuar se “dialogu nuk është prioritet” dhe se ai “nuk e vazhdon këtë dialog që ekziston”.²⁰ Pasi është zgjedhur në krye të Qeverisë, ai e ka marrë një qëndrim më pak refuzues për dialogun, duke thënë se “dialogu është i paalternativë” dhe se synimi duhet të jetë organizimi i një “diskutimi të brendshëm” rreth dialogut me qëllim të arritjes së një pozicioni konsensual.

Dëshmi shtesë se dialogu shihet si barrë e padëshiruar nga ana e Qeverisë mund të shihet edhe tensionimi i raportuar mes kryeministrit Haradinaj dhe përfaqësueses së lartë Mogherini, në takimin e Këshillit të Stabilizim-Asocimit BE-Kosovë, ku sipas mediave zyrtarja e BE-së braktisi takimin pas kritikave të kryeministrit të Kosovës se “dialogu nuk nxjerr rezultate” dhe se “duhet përfshirje më e madhe amerikane”.²¹

Dialogu i Brukselit deri tani është udhëhequr nga Qeveria e Kosovës, e cila në mandatin e fundit madje ka pasur edhe një ministri për Dialog, ndërsa kryeministri i Kosovës ka qenë autoriteti nënshkrues i marrëveshjeve kryesore me Serbinë.²² Megjithatë, përfshirja e Qeverisë në dialog deri tani ka dhënë rezultate të kufizuara, dhe jo gjithnjë pozitive; derisa në më shumë se gjashtë vjet të dialogut²³ një numër i konsiderueshëm marrëveshjesh janë arritur, zbatimi i tyre ka qenë vazhdimisht një problem, ndërsa disa prej marrëveshjeve kanë shkaktuar përplasje dhe kundërshtime të mëdha brenda Kosovës. Sidomos Marrëveshja e prillit²⁴ dhe ajo e parimeve për

¹⁷ Rezoluta e Kuvendit të Kosovës e datës 18 tetor 2012 në mënyrë eksplicite autorizon vetëm Qeverinë e Kosovës për të udhëhequr procesin e bisedimeve për normalizim të marrëdhënieve me Serbinë.

http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/Rezolute_Marredhenive_Kosova_Serbia.pdf

¹⁸ PDK u themelua në tetor 1999, ndërsa Thaçi ishte kryetar i saj prej fillimit deri në prill 2016, kur u zgjodh president i Kosovës

¹⁹ Në Qeveritë e kryesuar nga Hashim Thaçi dhe Isa Mustafa, kryesuesja e Ekipit të Dialogut, Edita Tahiri, ka qenë ministre për dialog.

²⁰ Intervistë në emisionin “Rubikon” të KTV-së: <http://www.koha.net/arberi/25694/haradinaj-thote-se-nuk-e-ka-prioritet-dialogun-me-serbine-e-do-ameriken-pjesemarrese/>

²¹ Shërbimi në gjuhën serbe i Radios Evropa e Lirë ka raportuar i pari për tensionime në takimin e mbajtur më 17 nëntor 2017, dhe arsyet e largimit të Mogherinit, ndërsa kjo u raportua gjerësisht më pas nga shumë media tjera kosovare. BE-ja dhe Qeveria e Kosovës e kanë mohuar një gjë të tillë, por burimet diplomatike konfirmojnë se kjo ka ndodhur, dhe se për këtë arsye u anulua edhe konferenca e përbashkët Mogherini-Haradinaj, që duhej të mbahej pas takimit.

²² Ministria për Dialog është udhëhequr nga Edita Tahiri

²³ Në mars 2011 ka filluar i ashtuquajtur i Dialog Teknik, ndërsa në vjeshtën e vitit 2012 dialogu është ngritur në nivel politik, duke marrë më pas edhe emërtimin aktual: Dialog për Normalizim Marrëdhëniesh. Analiza mbështetet në këndvështrimin se i gjithë procesi i bisedimeve mes Kosovës dhe Serbisë, me lehtësimin e BE-së, është një tërësi.

²⁴ E ashtuquajtura Marrëveshja e Parë e Parimeve që Rregullojnë Normalizimin e Marrëdhënieve mes Kosovës dhe Serbisë, e arritur më 13 prill 2013, por ende e pazbatuar në pjesën më të madhe të saj: http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Marreveshja_e_Pare_per_Normalizimin_e_Marredhenieve_19_prill_2013.pdf

themelimi e Asociacionit të Komunave me Shumicë serbe²⁵ janë pritur me reagime të ashpra nga opozita, por edhe me mospajtim nga një pjesë domethënëse e shoqërisë.²⁶

Pjesë e problemit, natyrisht, është edhe fakti që ekipi kosovar i dialogut nuk e kishte të përfshirë në proces as opozitën e as shoqërinë civile, ndërsa raportimi në Kuvend bëhej më shumë formalisht dhe me vonesa.²⁷ Po ashtu, mungesa e transparencës në proces - e evidencuar në pothuaj të gjitha sondazhet e kryera rreth dialogut në Kosovë²⁸, por edhe e theksuar vazhdimisht si problem qenësor nga mediat dhe gazetarët që përcjellin procesin²⁹ - bashkë me interpretimet e kundërta që palët shpesh herë i kanë bërë marrëveshjeve, kanë thelluar mosbesimin në proces, dhe posaçërisht në ekipin që e përfaqëson Kosovën në bisedat e Brukselit.

Që nga viti i kaluar, sidomos gjatë muajve para zgjedhjeve parlamentare të 11 qershorit, kur procesi i dialogut ishte në krizë të thellë dhe kishte rrezik nga përshkallëzimi i konfliktit në veri, segmente qeveritare të përfshira në procesin e bisedimeve kanë përkrahur hapur idenë që në kuadër të ndryshimit të formatit të dialogut të krijohet hapësirë që në ekipin negociues të përfshihet edhe opozita. Kjo, në vetvete, dëshmon se vetë ekzekutivi kosovar është i vetëdijshëm se mungesa e fuqisë politike për të ratifikuar marrëveshjet e arritura dhe për t'i zbatuar ato e bën pjesëmarrjen e Qeverisë në dialog të jetë pothuajse absurde. Një gjë e tillë tërthorazi konfirmohet edhe nga propozimi i presidentit Thaçi, i cili për fazën e re të dialogut kërkon që të formohet një ekip uniteti, ku do të ishin të përfshirë edhe përfaqësues opozitarë, por edhe përfaqësues nga shoqëria civile³⁰.

Kuvendi

Në anën tjetër, Qeveria e re e Kosovës, përveçse nuk ka një zyrtar të nivelit ministror për të udhëhequr dialogun, ajo nuk duket se ka interesim që të vazhdojë procesin si deri tani. Vetë kryeministri Haradinaj ka deklaruar se dialogu nuk mund të vazhdojë kështu si është, ndërsa ka lënë të kuptohet se favorizon arritjen e një vendimi konsensual rreth dialogut në Kuvendin e Kosovës. Për këtë, ai madje ka paralajmëruar se Qeveria do të ofrojë një "platformë të re" për dialog, e cila do të diskutohet dhe miratohet në Kuvend³¹.

Një rol më të madh për Kuvendin e Kosovës në dialogun e Brukselit e kanë kërkuar edhe partitë opozitare. Madje, Lëvizja Vetëvendosje insiston që "Kuvendi duhet të jetë epiqendra e dialogut".³²

Por a është Kuvendi i Kosovës vendi ku mund të arrihet konsensusi i nevojshëm? Aktualisht Kuvendi nuk duket si forum që mund të prodhojë pajtim rreth dialogut. Në tre vjetët e fundit Kuvendi i Kosovës ishte skena e përplasjeve më të ashpra mes partive politike, ndërsa për shkak të mospajtimeve politike, Kuvendi më shumë kohë nuk funksionoi se që funksionoi.

²⁵ Marrëveshja e arritur më 25 gusht 2015, e cila është pritur edhe me pritesta të mëdha dhe të dhunshme, në dhjetor të vitit 2015 është gjykuar nga Gjykata Kushtetuese e Kosovës se nuk është në pajtim me Kushtetutën e Kosovës, dhe rrjedhimisht nuk mund të zbatohet pa u ndëryshuar. Prej atëherë themelimi i Asociacionit... ka ngecur

²⁶ Organizata të shoqërisë civile, personalitete publike dhe analistë të renomuar kanë kundërshtuar pjesë të marrëveshjeve publikisht dhe me shkrime të argumentuara e analitike

²⁷ Bisedë me një eksponent të shoqërisë civile

²⁸ Disa sondazhe kredibile rreth këndvështrimit të qytetarëve rreth dialogut janë kryer nga KDI dhe ato rregullisht nxjerrin mungesën e transparencës si një prej problemeve themelore të procesit. Sondazhet janë në dispozicion në:

www.kdi-kosova.org

²⁹ Bisedë me gazetarë/korrespondentë që raportojnë nga Brukseli

³⁰ Vet shoqëria civile, edhe pse aktive në analizën e procesit, nuk ka formuluar një qëndrim të përbashkët rreth asaj se çfarë ndryshimesh do të duhej të ndodhnin që dialogu të shndërrohej në një proces që efektivisht jep rezultate pozitive dhe ofron progres drejt normalizimit të marrëdhënieve mes Kosovës dhe Serbisë.

³¹ Haradinaj, në një intervistë dhënë për "Rubikon" të KTV-së: <http://www.koha.net/arberi/50158/haradinaj-paralajmeron-platforme-te-re-per-dialogun-me-serbine/>

³² Deklaratë publike e shefit të Grupit parlamentar të LVV-së, Glauk Konjufca:

<http://www.koha.net/arberi/49049/vetevendosje-do-qe-pergjegjesia-per-dialogun-me-serbine-ti-kthehet-kuvendit/>

E sipas një eksponenti të shoqërisë civile të përfshirë në vëzhgimin e punës së Kuvendit të Kosovës, ky institucion, edhe kur funksionoi, kryesisht ishte i kontrolluar nga mazhoranca qeverisëse; me gjithë mandatin ligjor si mbikëqyrës i Qeverisë dhe i institucioneve të tjera të shtetit, Kuvendi i Kosovës më shumë ka funksionuar si “servis i Qeverisë” sesa mbikëqyrës i saj³³.

Njëkohësisht, polarizimi i skajshëm mes koalicionit qeverisës dhe partive opozitare vazhdon, dhe nuk duket se situata në Kuvend do të mundë të ndryshonte në afat të shkurtër, edhe për faktin se partitë politike e shohin Kuvendin ose një instrument që shërben për kalimin formal të vendimeve qeveritare (koalicioni qeverisës) ose si një platformë përmes së cilës mund të bllokohet puna e qeverisë dhe, eventualisht, të imponohet rrëzimi i saj (opozita). Për më tepër, vetë konstituimi i këtij Kuvendi dhe zgjedhja e kryesuesit të tij ishte pjesë qëndrore e krizës politike, që nënkupton se institucioni përfaqësues i popullit “është pjesë e problemit, jo zgjidhja e tij”.³⁴

Në anën tjetër, koha për formulimin e pozicionit të ri të Kosovës po skadon; në Bruksel, por edhe tek kryeqendrat tjera perëndimore, po “shpenzohet durimi” me Kosovën, e cila “duket e paaftë për të arritur pajtim edhe rreth gjërave më bazike që janë në interes të vendit”.³⁵

Në një rrethanë të tillë, Kuvendi i Kosovës – i cili në demokracinë parlamentare është pikërisht vendi ku duhet arritur konsensusi dhe vendimet rreth çështjeve të interesit shtetëror dhe nacional – zor se mund të jetë “epiqendra e dialogut”, edhe pse, roli i tij në krijimin e mandatit të ri për dialog nuk mund të shmanget: Pa një rezolutë të re të Kuvendit të Kosovës, në fuqi mbetet Rezoluta e cila mandatin ekskluziv për të përfaqësuar Kosovën në dialog me Serbinë ia jep Qeverisë.³⁶

Rruga përpara

Vështruar kështu, duket se asnjëri nga tri institucionet kryesore të shtetit – Kuvendi, Presidenca dhe Qeveria – nuk do të mundë të gjeneronin konsensusin e kërkuar as për ndryshimet e formatit të dialogut, e as për ndryshimin e përmbajtjes së tij.³⁷ Megjithatë, dialogu as nuk mund të shmanget e as të shtyhet gjatë, dhe institucionet e Kosovës nuk do të mundë t’u ikin pjesëmarrjes në bisedime, edhe nëse ndryshon formati dhe përmbajtja e tyre.³⁸

Andaj, pyetja që tani shtrohet nuk ka të bëjë vetëm me (pa)aftësinë e politikës kosovare për të prodhuar konsensus rreth një procesi madhor siç është dialogu³⁹, por edhe më shumë me pasojat që mund t’i vuajë Kosova nëse vazhdimi i dialogut e gjen të përçarë dhe të papërgatitur. Një përsëritje e tensioneve dhe përplasjeve që tashmë janë parë pas gushtit 2015, kur dy marrëveshje⁴⁰ u nënshkruan pa pajtimin e opozitës parlamentare është e mundshme të përsëritet, derisa nuk do mend se kritika dhe presioni ndërkombëtarë do të shtoheshin.⁴¹

Rrjedhimisht, është në interesin strategjik dhe shtetëror të Kosovës që një rrugë e re përpara drejt konsensusit të kërkohet dhe të gjendet, dhe madje urgjentisht. Është e nevojshme një

³³ Bisedë me një eksponent të shoqërisë civile, vëzhgues i punës së Kuvendit të Kosovës

³⁴ Bisedë me një eksponent të shoqërisë civile, vëzhgues i punës së Kuvendit të Kosovës

³⁵ Bisedë me një diplomat evropian

³⁶ Rezoluta e miratuar më 18 tetor 2012

http://www.assembly-kosova.org/common/docs/Rezolute_Marredhenive_Kosova_Serbia.pdf

³⁷ Krahas diskutimeve për ndryshim të formatit të dialogut, në Kosovë po kërkohet dhe debatohet për ndryshim edhe të përmbajtjes së tij, me disa tema që insistohet se duhet të përfshihen në bisedime, sikur që janë çështja e të pagjeturve dhe ajo e reparacioneve të luftës

³⁸ Bisedë me një diplomat evropian

³⁹ Ka vite që Kosova merr pjesë në dialog pa konsensus, apo së paku nënshkruan marrëveshje pa konsensus të brendshëm, ndërsa qeveritë e njëpasnjëshme të vendit rëndom kanë marrë dhe marrin vendime pa kërkuar pajtim apo përkrahje përtej shumicës së thjeshtë parlamentare.

⁴⁰ Marrëveshja për demarkacion me Malin e Zi dhe Marrëveshja e Parimeve të Përgjithshme/Elementeve Kryesore të Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe

⁴¹ Bisedë me një ish-diplomat amerikan

përpjekje e re e partive politike parlamentare për t'i dhënë kornizë konsensusit të mundshëm, dhe madje në këto tri pika themelore:

- Cili duhet të jetë formati i ri i dialogut të Brukselit dhe kush duhet ta përfaqësojë Kosovën në të?
- Cilat çështje duhet diskutuar/negociuar në dialogun e Brukselit?
- Cili është synimi që Kosova ka në këtë dialog?

Natyrisht, nuk kufizohet i gjithë debati në këto tri pyetje; në kuadër të diskutimeve tashmë janë hapur edhe tema tjera, sikur që është kërkesa për një rol më të madh të Shteteve të Bashkuara të Amerikës në dialog⁴², apo ideja që krahas dialogut me Serbinë Kosova të hapë një dialog tjetër me komunitetin serb të Kosovës për të diskutuar çështjet e brendshme prej të cilave disa po diskutohen edhe në Bruksel.⁴³ Por, këto dhe çështje të ngjashme janë pjesë të një pamjeje më të madhe, ndërsa synimi emergjent në këtë moment do të duhej të ishte të përcaktohej korniza e asaj pamjeje.

Andaj, një nga zgjidhjet e mundshme për të ecur përpara do të ishte edhe formimi i një *Forumi Politik për Dialog*, që do të shërbente si platformë e afatizuar për diskutim mes faktorëve politikë dhe shoqërorë në kërkim të konsensusit të nevojshëm rreth dialogut.

Ky propozim, edhe pse jo e vetmja rrugë e mundshme përpara, në momentin e dhënë na duket si më efikasja për të zhbllokuar situatën e cila ka kohë që e ka paralizuar vendimmarrjen konsensuale në vend, jo vetëm rreth çështjes së dialogut.⁴⁴

Forumi Politik për Dialog

Forumi Politik për Dialog do të mundë të lansohet shpejt dhe pa kundërthënie nga shoqëria civile, si platformë joformale për diskutimin e dialogut, në të cilën marrin pjesë përfaqësues të partive politike parlamentare, por edhe personalitete dhe individë tjerë nga jeta politike, institucionet dhe organizatat e shoqërisë civile të Kosovës. Organizimi i tillë nga shoqëria civile do të shmangte përplasjen partiake rreth pronësisë së procesit.⁴⁵

Me një pajtim në parim nga partitë politike parlamentare, organizatori/bartësi i kësaj nisme do të mundë të jetë një koalicion organizatash të shoqërisë civile, që tashmë janë marrë sistematikisht me analizimin dhe monitorimin e procesit të dialogut, të asistuar nga donatorë aktivë në këtë fushë.

Ky organizëm do të mundë të quhej *Koalicioni për Dialog*. Koalicioni për Dialog do të duhej të formalizohej përmes një *memorandumi*, do të kishte mandat për të organizuar debatin, me synimin për të gjeneruar përgjigjet konsensuale në tri pyetjet themelore rreth dialogut, të përmendura më lart.

⁴² Një kërkesë të tillë përveç tjerëve, së fundi e ka theksuar edhe kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj.

⁴³ Hapja e dialogut të brendshëm me serbët kosovarë është një prej ideve të Lëvizjes Vetëvendosje, pozicioni i së cilës tashmë ka evoluuar prej refuzimit të bisedave me Serbinë në kërkesë për ndryshim të formës dhe përmbajtjes së këtyre bisedave. Për më tepër, shih propozimin e Albin Kurtit se si duhet vazhduar dialogu me Serbinë, bërë në qershorë në cilësinë e kandidatit për kryeministër, shkurt pas zgjedhjeve parlamentare: <http://www.koha.net/arberi/27761/kurti-shpalos-nente-pikat-per-dialogun-me-serbine/>

⁴⁴ Forumi Politik të krijohet ekskluzivisht për afrimin e çështjes së konsensusit rreth dialogut, meqë ideja nuk është të zëvendësohen institucionet ekzistuese të shtetit, por të ndihmohen ato në një prej çështjeve ku ngecja e mëtutjeshme do të jetë shumë e kushtueshme.

⁴⁵ Një nga arsyet pse duket se partitë politike kosovare e kanë të vështirë arritjen e çdo konsensusi duket të jetë edhe kontestimi se kush duhet udhëhequr procesin e ndërtimit të konsensusit.

Vetë debati duhet të jetë publik dhe i hapur për pjesëmarrje të ndryshme, në një konferencë disaditëshe, në të cilën do të referoheshin propozimet e ndryshme dhe do të diskutoheshin zgjidhjet reale dhe konsensuale.

Koalicioni organizues i debatit do të duhej të formonte *Sekretarinë e Forumit*, e cila do të jetë përgjegjëse për aspektet teknike të debatit: caktimi i folësve, kohëzgjatja e referateve, pranimit dhe shpërndarja e dokumenteve të konferencës tek pjesëmarrësit, përkthimi, logjistika, etj.

Pjesë aktive e debatit duhet të jenë dhe individë apo organizata që ofrojnë këndvështrimin ndërkombëtar rreth çështjes, për çka një pjesëmarrje e përzgjedhur dhe aktive e diplomatëve të akredituar në Prishtinë është e domosdoshme, sikur edhe e një numri të personaliteteve ndërkombëtare me ekspertizë të provuar në çështjen e Kosovës, e që do të shërbenin si këshilltarë të Jashtëm⁴⁶, gjithnjë me synimin që të arrihen përgjigje konsensuale për tri çështjet e lartpërmendura, por edhe të definohej aspekte të tjera të padefinuara deri tani, siç janë:

- Hartimi i listës së çështjeve që Kosova do t'i hapë në dialog
- Hartimi i listës së çështjeve që Kosova nuk do t'i hapë në dialog
- Hartimi i pozicionit të Kosovës rreth marrëveshjes së mundshme finale Kosovë-Serbi
- Hapja eventuale e një dialogu me serbët kosovarë, të ndarë nga dialogu i Brukselit, dhe implikimet e mundshme të një procesi të tillë, etj.

Po ashtu, pjesë e synimit në këtë proces do të jetë edhe adresimi i çështjeve të tjera, më teknike, siç janë:

- Varësisht nga formati i ardhshëm, kush do të marrë përgjegjësinë për zbatimin e marrëveshjeve nga dialogu?
- Cili do të jetë mekanizmi i raportimit dhe llogaridhënies institucionale?
- Si dhe sa mund të afatizohet procesi i dialogut?, etj.

Të gjitha diskutimet-propozimet e bëra në konferencë do të jenë në dispozicion për publikun dhe komentet eventuale me shkrim apo online në një web faqe të veçantë të Konferencës për Dialog, ndërsa brenda një afati optimal (2-3 javë) Koalicioni për Dialog do të prodhojë një dokument me konkludimet dhe propozimet konsensuale, që do të kalonte për debat formal në Kuvendin e Kosovës.

Partitë politike pjesëmarrëse do të duhej të pajtoheshin që në fillim se do t'i bartin konkludimet e Forumit për diskutim formal dhe vendimmarrës në Kuvendin e Kosovës.

Tutje, Kuvendi i Kosovës do të ishte i obliguar të miratonte një rezolute të re për dialogun, e cila ka përgjigjet në tri pyetjet themelore, me çka edhe do të përcaktonte mandatin e ri të ekipit përfaqësues të Kosovës në dialogun e Brukselit, si dhe përbërjen e tij.

Qeveria dhe presidenti do të ishin të obliguara që të respektojnë dhe zbatojnë vendimin e Kuvendit.

Rezoluta, bashkë me dokumentin konsensual të hartuar nga Koalicioni për Dialog në emër të Konferencës, do t'i prezantohej Përfaqësueses së Lartë të BE-së, si qëndrim zyrtar i Kosovës rreth formatit të bisedimeve në Bruksel dhe së ardhmes së dialogut Kosovë-Serbi.

⁴⁶ Një listë e gjerë e personaliteteve të tilla mund të hartohet. Ndër propozimet do të mundë të konsiderohet ftesa për diplomatët që tashmë kanë qenë pjesë e proceseve rreth Kosovës, siç janë presidenti Martti Ahtisaari, z. Albert Rohan dhe ambasadori Wolfgang Ischinger, por edhe ekspertë ndërkombëtarë nga fushat tjera, siç janë profesori i së drejtës ndërkombëtare Marc Weller, ish-diplomati dhe eksperti amerikan Dan Serwer, gazetari britanik Tim Judah, apo analisti gjerman Bodo Weber.

Analiza e Politikave

Analizat e Politikave janë raporte që diskutojnë politikat publike dhe që synojnë të ndikojnë në vendimmarrje, si në nivelin lokal ashtu edhe në atë qendror të qeverisjes. Qëllimi i Analizës së Politikave është të adresojë një problem të veçantë, më në thellësi, të shqyrtoj argumentet e ndërlidhura me politikën përkatëse, dhe të analizojë zbatimin e saj. Përmes Analizës së Politikave, Grupi për Studime Juridike dhe Politike synon të stimulojë debat më të gjërë dhe gjithëpërfshirës mbi çështjen e dhënë, si dhe të ofroj zgjidhje të informuara dhe rekomandime për ndryshimin e politikave publike relevante, kryesisht drejtuar aktorëve dhe grupeve të interesit.



**GROUP FOR LEGAL
AND POLITICAL
STUDIES**

legalpoliticalstudies.org